



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

Në përputhje me nën-pjesët 2, 4, 6 dhe 7 të Nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjatë takimit të Kabinetit të mbajtur më 04 korrik 2008, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë direktivën e mëposhtme:

#### DIREKTIVË PËR POLITIKËN LIDHUR ME PARTNERITETET PUBLIKE-PRIVATE

Ndërsa:

- a) Republika e Kosovës ka nevojë urgjente për investime substanciale në infrastrukturën e saj publike dhe shërbimet në të gjithë sektorët;
- b) Qeveria e Kosovës, institucionet e saj, dhe ndërmarrjet në pronësi publike kanë resurse të kufizuara financiare dhe duhet të ushtrojnë maturi fiskale për të siguruar rritje të qëndrueshme ekonomike;
- c) Modernizimi i infrastrukturës së Kosovës dhe shërbimeve publike është i nevojshëm për të mundësuar konkurrimin e suksesshëm të saj me ekonomitë tjera në rajon;
- d) Qeveria e Kosovës njeh faktin që sektori privat është gur themel i çdo ekonomie moderne dhe kërkon mundësi për investime për të shënuar rritje dhe për të krijuar vende të reja pune;
- e) Partneritetet Publike-Private (PPP) janë mekanizëm kontraktues modern përmes të cilit autoritetet publike dhe sektori privat bashkëpunojnë për të siguruar financimin, ndërtimin, rinovimin, menaxhimin, operimin dhe/apo mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe/apo shërbimeve;
- f) PPP-të janë parakusht i sigurimit të rritjes së infrastrukturës së Kosovës pa mbingarkuar financat e Qeverisë;
- g) Infuzioni i kapitalit dhe menaxhimit privat në punët dhe shërbimet publike mund të lehtësojë shtrëngesat fiskale dhe të shtojë efikasitetin, duke siguruar njëkohësisht infrastrukturë dhe shërbime të reja;
- h) Qeveria e Kosovës njeh faktin që pjesëmarrja e sektorit privat në punët dhe shërbimet publike duhet të bëhet në mënyrë të rregullt dhe të arsyeshme, me qëllim të mbrojtjes së interesit publik, rritjes në maksimum të vlerës për para, dhe sigurimit të ndarjes së përshtatshme të rreziqeve; dhe
- i) Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në të siguruarit që shërbimet publike dhe infrastruktura publike janë të arritshme dhe efikase;

Prandaj:

- I. Përmes kësaj, Qeveria e Kosovës deklaron përkrahjen e saj të qartë për implementimin e partneriteteve publike-private si mënyrë për stimulim të investimeve në infrastrukturën publike dhe në sigurimin e shërbimeve publike;
- II. Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e sektorit privat në sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në nivel të qeverisë qendrore dhe në nivel komunal, sa herë që shfrytëzimi i PPP-ve do të krijojë vlerë më të mirë për para;
- III. Për të siguruar që projektet janë të qëndrueshme dhe të suksesshme, duke minimizuar njëkohësisht rreziqet dhe detyrimet e sektorit publik, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në implementimin e PPP-së në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare; dhe
- IV. Qeveria e Kosovës është vendosmërisht e përkushtuar për implementimin e PPP-së përmes procedurave konkurruese, të drejta dhe transparente dhe do të insistojë –pa asnjë përjashtim – që të gjitha palët pjesëmarrëse në PPP të veprojnë me besnikëri në pajtim me të drejtat dhe obligimet e tyre përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

---

Kryeministri i Kosovës  
Hashim Thaçi

Vendimi u dërgohet:

- Ministrive (Ministrave)
- Ndërmarrjeve në pronësi publike
- Komunave
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë